



Financuar nga Leviz Albania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

ME GRATË PËR BLEGTORINË



**Projekt i zbatuar nga Shoqata Vizion Gruaje
në Bashkitë Poliçan dhe Skrapar**

Mars 2020 – Janar 2021

SHOQATA VIZION GRUAJE KONSTATON:

- **Gjendja e tregjeve publike që ndodhen në zemër të kryeqendrave të dy bashkive, Çorovodës dhe Poliçanit është shumë e rëndë.** Qumshti dhe bulmeti i prodhuar me aq mund nga gratë blegtoare tregtohet në diell, në shi, në tezgat bashkiake ose edhe përtokë, në të njëjtin vend ku shiten edhe rroba të vjetra, apo artikuj shtëpiakë, perime dhe fruta, edhe peshk.



- **Nuk ekzistojnë tregje bashkiake vetëm për nënproduktet blegtorale.**



- Cilësia e nënprodukteve blegtorale, që ende prodhohen me dorë, në kushte shtëpie, nga gratë blegtoare, janë një mall që do të konkurronte gjithçka, por kalvari për t'i transportuar drejt qendrave të banuara, **kalvari për t'i shitur në tregje që vetëm tregje nuk janë**, nuk është vetëm hall i blegtorit që mezi i prodhon, por **është edhe një mundësi e frikshme infeksionesh dhe pasigurie ushqimore për konsumatorët.**



- **Gratë blegtove të Skraparit dhe Poliçanit dhe produktet e tyre meritojnë të kenë një Treg publik me parametra cilësore!**



- **Krijimi i mundësive për shkëmbime dhe mbi të gjitha lehtësimi i gjetjes së tregjeve vendore për produktet e grave blegtove do të thotë t'u japësh "oksigjen" dhe t'u hapësh perspektiva produktit vendor, njerëzve që prodhojnë dhe të shtosh në numër dhe cilësi produktet për ata që konsumojnë.**




- **70 % e grave blegtoresh të intervistuar në njësitë administrative rurale të Skraparit duan t'i shesin produktet e tyre për të mbajtur ekonominë familjare; jo të gjitha ia dalin.**



- **Një treg publik i produkteve dhe nënprodukteve blegtorale do të kishte një impakt të fuqishëm për blegtorët në Bashkitë Skrapar dhe Poliçan: Më shumë të ardhura dhe mirëqenie; Shtim të fuqisë blerëse dhe shtim të numrit të bagëtisë që mbarështojnë; Diversifikim të produkteve dhe shtim të investimeve; Gjenerim hallkash dhe procesesh të reja të ekonomisë qarkulluese në të gjithë territorin e bashkisë.**
Krijimi i një Tregu publik cilësor në qytetin e Çorovodës dhe atë të Poliçanit do ta shndërronte këtë veprimtari prodhuese në vlerë zhvillimi për zonën.



- **Një treg publik cilësor i produkteve dhe nënprodukteve blegtorale me nam të zonës sonë do të ishte vendi i “Mikpritjes skraparase”/“... poliçanase” edhe për turistët e shumtë vendas dhe të huaj që i frekuentojnë gjatë gjithë vitit dy Bashkitë.**



SHOQATA VIZION GRUAJE KËRKON:

1. Ngritjen e një tregu publik modern dhe të aksesueshëm për gjithkënd, i dedikuar vetëm për tregtimin e nënprodukteve blegtorale në qytetet e Çorovodës dhe Poliçanit.
2. Sigurimin nga bashkia të personelit të specializuar mbikëqyrës që do të garantojë cilësinë e tregimit të produkteve dhe sigurinë ushqimore për konsumatorët.
3. Taksim zero të grave blegtore nga njësitë administrative rurale të të dy bashkive Skrapar dhe Poliçan që vijnë të tregojnë nënproduktet e tyre blegtorale në tregun publik të Çorovodës dhe Poliçanit.



**Realizuar me mbështetjen
e Lëviz Albania**



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Ky material informues u realizua nga Shoqata Vizion Gruaje në kuadër të projektit “Me Gratë për Blegtorinë”, me mbështetjen financiare të LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.